



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI PENAL**

**Nr. 61005-00003-00-2023 i Regj. Themeltar  
Nr. 00-2023- 231 i Vendimit**

**VENDIM**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Illir PANDA</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Sokol BINAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Sandër SIMONI</b>	<b>Anëtar</b>

sot në datë 07.02.2023, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen penale nr.61005-00003-00-2023, që i përket:

**KËRKUES:** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin

**KUNDËR:** Personit nën hetim Jeton Lami

**OBJEKTI:** Marrjen në pyetje të personit nën hetim Jeton Lami.  
Mosndryshimin e vendimit nr. 893 datë 23.08.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin me të cilin është vendosur masa e sigurimit "arrest në burg" parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale

**KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit Sandër Simoni dhe bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN SE:**

**I. Rrethanat e çështjes**

1. Nga aktet e procedimit penal rezulton se; në datë 10.08.2022 shtetasi Faik Haxhi Martinaj, i datëlindjes 15.12.1966, banues në Fushë- Kuqe, paraqiti një kallëzim penal në Komisaratin e Policisë Kurbin. Ai është xhaxhai i shtetasit Ervis Martinaj, datëlindjes 06.10.1982, banues në Fushë-Kuqe, Kurbin. Kallëzuesi bëri me dije se kishin humbur kontaktet me nipin e tij, ndërkohë që ky fundit ishte person i shpallur në kërkim ndërkombëtar (Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr.42, datë 17.05.2022 ka caktuar masën e sigurimit personal "arrest në burg" për veprat penale të parashikuara nga nenet 80, 28/4, 933/a dhe 334 të Kodit Penal). Shtetasi Faik Martinaj në kallëzimin e tij ka shpjeguar se në datë 09.08.2022, rreth orës 22.00, janë njoftuar nga një i afërmi i tyre që ndodhet jashtë shtetit dhe që për arsye sigurie nuk e identifikon me emër, i cili kishte humbur kontaktet me nipin e tij Ervis

Martinaj. Telefoni i këtij të fundit rezultonte i fikur, çka e bënte të dyshonte se mund të ishte zhdukur nga persona të pidentifikuar. Shtetasi Faik Martinaj shpjegon se që prej kohës që nipi i tij Ervisi është shpallur në kërkim nga organet e drejtësisë, ai dhe familja e tij nuk kishin pasur kontakte me të dhe nuk kishin dijeni për vendndodhjen e tij.

2. I pyetur lidhur me motivet dhe personat që mund të jenë përfshirë në zhdukjen e nipit të tij, ky shtetas sqaron se që prej dhënies së dëshmisë së shtetasit Nuredin Dumani, i cili e akuzonte nipin e tij Ervisin për disa krime të rënda, kishin filluar edhe problemet për Ervisin, duke hedhur dyshime për grupe kriminale dhe posaçërisht tek shtetasi Endrit Dokle. Lidhur me faktin e kallëzuar është pyetur si person që ka dijeni për veprën penale edhe shtetasi Mustafa Martinaj, babai i shtetasit Ervis Martinaj, i cili ka dhënë të njëjtat shpjegime lidhur me kohën dhe rrethanat e zhdukjes së djalit të tij Ervis Martinaj, duke deklaruar se kontakt i fundit me të kish qenë në datë 09.08.2022, ora 19:30 (me të afërmin e tyre që ndodhet jashtë shtetit dhe që nuk tregohet se kush është).

3. Pas referimit të akteve, në datë 11.08.2022, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka regjistruar procedimin penal nr. 203, viti 2022 për veprat penale "Rrëmbimi dhe mbajtja peng e personit" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 109/1 dhe 25 të Kodit Penal. Në datë 15.08.2022, në vijim të veprimeve hetimore është pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale shtetasja Sadete Kokomani, e datëlindjes 01.10.2000, banuese në Durrës, e cila rezultonte të ishte një nga kontaktet e shtetasit Ervis Martinaj. Ndër të tjera ajo ka shpjeguar se, me shtetasin Ervis Martinaj është njohur në muajin Janar të vitit 2022, pasi ai i ka shkruar në rrjetin social "Instagram". Ervisi ka pasur adresën në instagram me emrin "King Simba" dhe foto profili ka pasur një luan. Pas disa komunikimeve, për herë të parë është takuar me Ervisin në Durrës, në datë 07.01.2022, përpara hotel "Palace" në plazh. Ervisi kishte shkuar vetëm, me një automjet "BMW", seria 7, targat e të cilit nuk i mban mend. Atë ditë është nisur bashkë me Ervisin me mjetin që përmendi më lartë për në Tiranë, por duke qenë se kishte trafik rrugës janë kthyer dhe kanë shkuar tek "Arbëria Palace" në Fushë-Milot, ku kanë pirë kafe dhe më pas kanë shkuar për të ngrënë drekë në Patok, tek lokali i hallës së Ervisit, i cili ishte me shtëpiza të vogla dërrase. Pas këtij takimi kanë vijuar takimet normalisht me Ervisin.

4. Në datë 05.08.2022, rreth orës 17, deklaruesja është nisur me taksi nga Durrësi për në Tiranë, pasi kishte komunikuar me Ervisin në aplikacionin "Telegram", për të parë një shtëpi që do e merrte me qira. Pasi ka parë shtëpinë, ka marrë një taksi dhe ka shkuar tek "Hygeia" në Tiranë, pasi Ervisi i kishte shkruar që po e priste atje. Ervisi ka qenë në një automjet "Audi" A-8, me targa të huaja, i ulur në vendin e parë të pasagjerit, ndërsa në vendin e drejtuesit ka qenë një person tjetër, që Ervisi e mbante afër vetes si shofer, rreth 30 vjeç, me flokë pak të rëna përpara dhe mbante pak mjekër. Ajo ka hipur në ulësen e pasme të mjetit dhe janë nisur nga Tirana për në Durrës. Fillimisht bënë një xhiro me mjet deri në Golem dhe më pas kanë shkuar tek hotel "Adriatiku". E pyetur lidhur me rezervimin e dhomës së hotelit shtetasja Sadete Kokomani ka shpjeguar se, dhomën e ka rezervuar personi që i shoqëronte (shoferi), ndërsa ajo me Ervisin kanë shkuar tek bari i hotelit dhe më pas janë ngjitur tek dhoma e hotelit, ku kanë qëndruar deri ditën e nesërme në datë 06.08.2022 rreth drekës, kohë kur janë larguar nga hoteli.

5. Nga ana e policisë gjyqësore janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale pamjet filmike të marra nga kamerat e sigurisë së hotel "Adriatik", që ndodhet në Durrës, ku pas këqyrjes së pamjeve filmike ka rezultuar se: në sekuecën filmike 21:14:18 të datës 05.08.2022 tek trau res hotelit "Adriatik" vjen një automjet veturë e markës "Audi" tipi AB, ngjyrë e zezë. Pasi kalon pak sekonda ngrihet trau dhe automjeti vijon lëvizjen në ambientet e parkimit të hotel Adriatik. Pasi ndalon nga mjeti duket që zbresin tre persona, dy meshkuj dhe një femër, të cilët më pas lëvizin në këmbë në drejtim të hotel "Adriatik". Njëri nga meshkujt i cili duket trup mesatar, mban të veshur pantallona tre çerekesh ngjyrë të zeza, bluzë me mëngë të shkurtra ngjyrë të bardhë, kapele sportive të zezë dhe atlete, cili më pas është identifikuar si shtetasi Ervis Martinaj, datëlindjes 06.10.1982. Personi tjetër i seksit mashkull, me trup të gjatë, mban veshur pantallona tre çerekësh të zeza me viza të bardha

anash, bluzë me mëngë të shkurtra jeshile, atlete të zeza dhe në dorë mban nje çantë, i identifikuar si shtetasi Jeton Lami, i datëlindjes 30.01.1994. Personi femër me floke te gjata të zeza, mban veshur një pale pantallona xhins të shkurtra, një kanotiere te zeze dhe në dorë ka një qese, e identifikuar si shtetasja Sadete Kokomani, e datëlindjes 01.10.2000. Te tre personat lëvizin bashkë drejt hotelit dhe futen brenda. Në sekuencën filmike 21:42:38, personi me trup i gjatë, që mban veshur pantallona treçerek të zeza me viza të bardha anash, me bluzë me mëngë të shkurtra ngjyrë jeshile dhe atlete të zeza, i identifikuar si Jeton Lami, afrohet tek recepsioni i hotelit, ku pasi komunikon me receptionisten duket që jep diçka dhe pasi shkruan një formular largohet. Nga këqyrja e regjistrit te hotel "Adriatik" është konstatuar se personi i cili ka rezervuar dhomën e hotelit është shtetasi Jeton Lami, i datëlindjes 30.01.1994, me letërnjoftimin me nr. 340130075C, dokument i cili është fotokopjuar nga personeli i recepsionit të hotelit dhe i është bashkëlidhur formularit të rezervimit të dhomës.

6. Nga verifikimet e kryera rezulton se shtetasi Jeton Lami, i biri i Lutfi dhe Hike, lindur me 30.01.1994 në Tiranë dhe banues në Rrugën "Azem Galica" në Kamëz, Tiranë është punonjës i Policisë së Shtetit, me detyrë N/specialist në Sektorin e Forcës së Posaçme Operacionale për Hetimin dhe Kërkimin, në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

7. Nga verifikimet e kryera si më sipër dhe pas referimit të akteve prokurorit, u vlerësua se ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se shtetasi Jeton Lami, ka kryer veprën penale të shpërdorimit të detyrës, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Mbi bazën e akteve të mësipërme, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin ka paraqitur kërkesën për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg" parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale" ndaj personit nën hetim Jeton Lami.

8. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin me vendimin nr. 893-81, datë 23.08.2022 ka vendosur pranimin e kërkesës dhe caktimin ndaj personit nën hetim Jeton Lami të masës së sigurimit personal "arrest në burg", në mungesë, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, i dyshuar për veprën penale të "shpërdorimit të detyrës", të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

9. Ky vendim është ekzekutuar nga ana e shërbimeve të policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Kurbin në datë 23.08.2022, ora 13.00 dhe në vijim nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin është paraqitur kërkesa për verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit dhe marrjen në pyetje të të arrestuarit Jeton Lami.

**10. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin** me vendimin nr. 894-82, datë 25.08.2022 ka vendosur: *"Pranimin e kërkesës. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal "arrest në burg" për shtetasin Jeton Lami, të parashikuar nga nenet 232 dh dhe 238 të Kodit të Procedurës Penale, të vendosur me vendimin nr. 893-81, datë 23.08.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin*

*Urdhërohet Komisarati i Policisë Kurbin për ndjekjen dhe ekzekutimin e këtij vendimi."*

11. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin ndër të tjera ka arsyetuar se, gjykata personin nën hetim e mori në pyetje brenda 3 ditëve nga kapja (ndalimi) e tij, konkretisht ai u ndalua në datë 23.08.2022, ora 13:04 PM, ndërsa marrja në pyetje u realizua në datën 25.08.2022. Në lidhje me ekzistencën e kushteve dhe kriterëve për vendosjen e masës së sigurimit arrest në burg dhe verifikimin e shkallës së nevojave të sigurimit, gjykata çmon se ato nuk kanë ndryshuar, referuar faktit se personi nën hetim mbajti qëndrim mohues, duke mos pranuar të merret në pyetje nga ana e gjykatës, por edhe prokurorisë, duke theksuar se është dakord me qëndrimin e mbajtur nga mbrojtësit, ku lidhur me provat, vërtetësinë e tyre dhe veprën penale, që atribuohet do të mbajë qëndrim në një moment të dytë.

11.1 Në këtë seancë gjyqësore të marrjes në pyetje, personi nën hetim, nëpërmjet mbrojtësve të zgjedhur theksoi se jemi në kushtet e caktimit të një mase më të butë siguri, pasi nuk ekzistojnë kushtet dhe kriteret për caktimin e një mase shtrënguese si ajo e "Arrestit

ne burg", duke e zëvendësuar dhe caktuar masën e "Detyrimit për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", parashikuar nga neni 234 K.Pr.Penale ose në mënyrë alternative "Arrest në shtëpi", parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, duke pretenduar se nuk ekziston rreziku i prishjes apo dëmtimit të provave sepse janë administruar dhe as rreziku i ikjes, pasi ka bashkëpunuar me organin procedues dhe i rrezikohet jeta nga izolimi për shkak të profesionit, duke mos argumentuar, referuar nenit 230 pika 1 të K.Pr.Penale, organi i akuzës se masa e "Arrestit në burg" mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme, për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit.

11.2 Sa më sipër, gjykata vlerëson se vendimi për caktimin e masës së sigurimit në mungesë, është i bazuar dhe nuk ka ndryshuar dhe të vijohet me zbatimin e tij, për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës penale dhe autorit, profesionit të tij, mënyrës së kryerjes së veprës penale dhe qëndrimit të tij në raport me faktin penal dhe veprën penale, që i atribuohet, duke mos dhënë shpjegime dhe në mungesë të provave të tjera shpresore, që nuk u paraqitën nga mbrojtësit apo personi nën hetim, duke vlerësuar gjykata vetëm ato që janë paraqitur nga organi i akuzës dhe janë administruar dhe vlerësuar më parë.

12. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim personi nën hetim Jeton Lami, me të cilin ka kërkuar ndryshimin e vendimit duke caktuar një masë sigurimi më të butë.

**13. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 801 datë 20.09.2022** ka vendosur: *"Miratimin e vendimit nr. 894-82 datë 25.08.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin."*

14. Gjykata e Apelit ndër të tjera ka arsyetuar se, me qëllim vlerësimin e përshtatshmërisë së masës së caktuar ndaj personit nën hetim, gjykata e apelit mban në konsideratë si rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale për të cilën po hetohet i dyshuari Jeton Lami, ashtu edhe rrezikshmërinë e këtij të fundit. Përpos kësaj, marrë në konsideratë nivelin e lartë të rreziqeve, që i kanosen procedimit penal, trajtuar më sipër në këtë vendim, vlerësohet se e vetmja masë që i garanton nevojat e sigurimit, është ajo e "arrestit në burg", sepse çdo masë tjetër sigurimi, e ndryshme, cënon sigurinë e procesit dhe zbulimin e fakteve që po hetohen.

15. Kundër vendimit nr. 801 datë 20.09.2022 të Gjykatës së Apelit Tiranë ka paraqitur rekurs më datë 18.11.2022 kërkuesi Jeton Lami me të cilin ka kërkuar: *Ndryshimin e vendimit penal nr. 801 datë 20.09.2022 të Gjykatës së Apelit Tiranë si vijon: Caktimin e masës së sigurimit "arrest në shtëpi", parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale ndaj personit nën hetim Jeton Lami.*

16. Në rekurs, kërkuesi ka ngritur ndër të tjera këto pretendime:

- Në rastin konkret nuk ka ndonjë të dhënë apo indicie që të vërtetojë vënien në rrezik të provës të marrjes së saj nga ana e rekursuesit Jeton Lami, prandaj vlerësojmë se kërkesa për caktimin e masës së sigurimit personal të caktuar nga gjykata nuk është në përputhje me kriteret e nenit 228/3/a, të Kodit të Procedurës Penale ku në mënyrë eksplicite përcaktohet se: masa e sigurimit personal vendoset kur kemi ekzistencën e shkaqeve të rëndësishme që në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës..."
- Në rastin konkret, provat janë marrë dhe sekuestruar në momentin e zbatimit të masës, rekursuesi ka vënë në dispozicion të organit procedues dy celularët e tij, madje duke i dhënë dhe kodin zhbllokues. Gjithashtu, janë sekuestruar një mori provash dhe kryer një sërë veprimesh hetimore, ndaj dhe nuk ka shkaqe që të sjellin njoftim mbi rrezikun e marrjes apo vërtetësisë së provave, nga veprimet eventuale të rekursuesit. E në këto kushte, vlerësojmë ky kriter ligjor është interpretuar dhe zbatuar nga gjykata në vendimin objekt rekursi, në kundërshtim me nenin 228/3/a të K.Pr.Penale dhe se në rastin konkret, nuk ka asnjë shkak të rëndësishëm që të vejë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës.
- Në lidhje me rrezikun e ikjes së të dyshuarit: Gjykata e Lartë, në Vendimin unifikues Nr.07, datë 14.10.2011, në lidhje me rrezikun e ikjes po shmangies së drejtësisë, është shprehur se: "ikja", "largimi" i të pandehurit është çështje akti, ka vend të evidentohet që pranimi nga gjykata i ekzistencës së mundësisë, pra "rrezikut të largimit", duhet të jetë më i motivuar, i mbështetur në elementë konkretë, në fakte e rrethana objektive.

Caktimi i masës së sigurimit sipas nenit 228, pika 1, shkronja "b", nuk mund të motivohet mbi baza thjeshtë hipotetike, në prezumime të përgjithshme apo imagjinare mbi probabilitet të ikjes së të gjykuarit."

- Në rastin në gjykim, nuk ka asnjë provë, indice apo fakt që të provojë se rekursuesi Jeton Lami, të mund të largohen apo ti shmanget hetimit, prandaj caktimi i masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues ekstrem "arrest në burg" e caktuar nga gjykata është marrë mbi baza hipotetike dhe imagjinare apo në prezumime mbi probabilitet të ikjes së rekursuesit, e për pasojë nuk është në përputhje me kriteret ligjore sipas nenit 228/3/b të Kodit të Procedurës Penale i cili përcakton se "masa e sigurimit personal vendoset kur ekziston rreziku që i dyshuari mund të largohet".
- Kështu, megjithëse ishte i njohur fakti që prokuroria po kryente hetime, rekursuesi nuk është larguar nga vendi, ç'ka do të kishte ndodhur nëse do të kishim qenë para rastit të pranuar "a priori" dhe padrejtësisht nga gjykata.
- Prandaj arrijmë në konkluzionin se rreziku i ikjes për Jeton Lamin është inekzistent, dhe se vendimmarrja objekt rekursi ka ardhur si rrjedhojë interpretimit dhe zbatimit të gabuar të nenin 8/3/a të K.Pr.Penale, si dhe në kundërshtim me Vendimin unifikues Nr.07, datë 14.10.2011, KBGJL.
- Në lidhje me rrezikun e kryerjes së një krimi më të rëndë ose të të njëjtit lloj: Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë përcaktuar disa nga rrethanat që vlerësohen për të analizuar rrezikun që i dyshuari të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për cilin procedohet. Rrethana të tilla janë; personaliteti i të pandehurit, nëse ka precedent penal, mënyra e jetesës së tij, vendi dhe rrethanat të cilat e kanë sjellë në kryerjen e veprës, rrethanat lidhur me natyrën, llojin, mjetet, kohën, vendin e mënyrën e kryerjes së veprës penale, llojin dhe shkallën e pasojave të ardhura nga kryerja e veprës, llojin e shkallën e fajësisë dhe motivet për kryerjen e veprës, sjellja e autorit si para ashtu edhe pas kryerjes së veprës, si dhe rrethanat e tjera të jetës individuale, familjare e sociale të tij.
- dhe kushti i fundit që lejon caktimin e masës së sigurimit personal në rastin tonë mungon. Konkretisht, organi i akuzës nuk ka asnjë provë dhe fakt që rekursuesi të mund të kryejë një krim tjetër, sic e përcakton neni 228/3/c i Kodit të Procedurës Penale ku theksohet se "masa e sigurimit personal vendoset kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet".
- Për më tepër që gjykata nuk ka vlerësuar drejt personalitetin e këtij shtetasi, i cili është i padënuar më parë dhe me arsim të lartë. Nisur nga sa më sipër, vlerësojmë se gjykata në interpretim dhe zbatim të gabuar të nenit 228/3/c të K.Pr.Penale e ka konsideruar si të vërtetuar "a priori" këtë kriter ligjor, i cili në vlerësim të mbrojtjes mungon tërësisht.

## II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

17. Së pari, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, (në vijim Kolegji) vlerëson se rekursi nga kërkuesi është paraqitur brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 435 të Kodit të Procedurës Penale. Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë është njoftuar për rekursin dhe nuk ka paraqitur kundër-rekurs.

18. Shkaqet e rekursit në Gjykatën e Lartë parashikohen nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale. Kjo dispozitë në pikën 1 të tij, parashikon se rekursi kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji material ose procedural i cili është me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; ose kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

19. Kolegji Penal vlerëson se asnjë nga pretendimet e ngritura në rekurs nuk i referohet shkaqeve të rekursit të parashikuara nga 432 i Kodit të Procedurës Penale. Pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Në të gjitha rastet kur rekursi nuk i përmbahet shkaqeve të përcaktuara nga neni 432/1 i Kodit të Procedurës Penale, Kolegji Penal vendos mospranimin e rekursit. Qëndrimi që mban Kolegji për rastin në shqyrtim, bazohet edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që referon në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilave shkaqet e parashtruara në rekurs që rezultojnë haptazi të pabazuara vlerësohen si të papranueshme për pranimin e rekursit.

20. Kolegji Penal vlerëson se asnjë nga pretendimet e parashtruara nga kërkuesi nuk i referohet shkaqeve të rekursit të parashikuara nga neni 432 i K.Pr.Penale. Kolegji vlerëson se Gjykata e Apelit Tiranë ka arsyetuar vendimmarrjen e saj dhe nuk ka shkaqe për çënimin e saj. Gjithashtu Kolegji nuk konstaton shkelje të ligjit material apo procedural penal prej Gjykatës së Apelit.

21. Sa më sipër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson se rekursi i paraqitur nga kërkuesi Jeton Lami kundër vendimit nr. 801 datë 20.09.2022 të Gjykatës së Apelit Tiranë nuk përmban ndonjë prej shkaqeve të sipërpërmendura dhe për rrjedhojë nuk mund të pranohet.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenet 433 dhe 441/1/a të Kodit të Procedurës Penale,

### **V E N D O S I:**

Mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi Jeton Lami kundër vendimit nr. 801 datë 20.09.2022 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

**Tiranë, më 07.02.2023**